



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 2

Rrogozhinë, më 30.06.2023 ora 10 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.2305.Prot datë 27.06.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.06.2023.
- 3- Shqyrtim i kërkesës për dorëheqje nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak të znj. Sadete Kaja.
- 4- Miratim i Komisioneve të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 7- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Gezime Met-hasani, Erind Tosku, Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Besnike Coraj, Saimir Cani, Altin Tosku, Fatbardha Sina, Sokol Gosa, Mitat Daja, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Lulzim Hasa, Bajazi Thaçi, Ferdi Avdiu, Alime Hoxha.

Të ftuar :



1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
4. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT.
5. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 15 Këshilltarë. Këshilltari z. Shpati Kolgega i bashkohet mbledhjes pak minuta pas fillimit duke e çuar në 16 numrin e pjesëmarrësve në mbledhje.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : z. Renato Kalemi, z. Enver Memolla, znj. Gezime Met-hasani, z. Altin Tosku, znj. Fatbardha Sina, z. Mitat Daja, z. Sokol Gosa, z. Saimir Cani, znj. Besnike Coraj, z. Indrit Dedej, znj. Silvana Aliu, z. Hekuran Xhani, z. Erind Tosku, znj. Fatmira Thartori dhe Mukades Gixhari.

Në mbledhjen e shkuar të datës 23.06.2023 u morën këto vendime nga Këshilli Bashkiak si më poshtë :

Vendim nr . 1 . Mbi miratimin e Komisionit të mandateve për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë.

Vendim nr . 2 . Mbi miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Vendim nr . 3 . Mbi zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Vendim nr . 4 . Mbi zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Vendim nr . 5 . Mbi zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Vendim nr . 6 . Mbi zgjedhjen e anëtarëve që përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut Tiranë.

Këto vendime të nderuar këshilltarë janë përcjellë për procedurë Prefektit të Qarkut Tiranë.



Kalojmë në rendin e ditës pika 1, Miratim i rendit të ditës. Keni ndonjë gjë në lidhje me rendin e ditës që ju ka ardhur secilit disa ditë më parë ndonjë pyetje sugjerim? Atëherë e hedhim në votim? Kush është pro për rendin e ditës? Abstenim, kundra? Të gjithë pro vota ime pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e dytë. Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.06.2023. Ka ndonjë pyetje në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? E hedhim në votim. Kush është pro?

Mitat Daja . Kam unë diçka, meqenëse është hera e parë që mar pjesë... Procesverbali përse nuk na jepet, përderisa ai transkriptohet përse nuk na jepet në çast se ne jo të gjithë mund t'i mbajmë mend se çfarë kemi diskutuar gjatë gjithë kohës? Këtë radhë ishin të qarta herët e tjera ndoshta nuk janë shumë të qarta. Mbarojmë mbledhjen mund të na jepen fletët që t'i shikojmë pastaj ... apo është procedurë gjithmonë që duhet të bëhet në këtë lloj forme, për mbledhjen e radhës?

Mukades Gixhari . Procedura është 5 ditë përpara meret informacioni...

Mitat Daja . Ne nuk e mbajmë mend se çfarë kemi miratuar gjatë kësaj kohe ose se kemi miratuar nuk e mbajmë mend.

Mukades Gixhari . Janë të shtjelluara të gjitha.

- *Mbledhjes i bashkohet këshilltari z. Shpati Kolgega në minutën e 4-ët të zhvillimit të mbledhjes*

Ervis Shera . Ju e doni 5-ditë pas mbledhjes e keni fjalën? Sepse do kohën e vet edhe zbardhja e procesverbalit.

Mitat Daja . Do kohë?

Ervis Shera . Do kohë. Në qoftë se do të bësh rakordimin pastaj fjala që ju keni thënë dhe procesverbali e shihni tek faqja e facebook-ut të Këshillit Bashkiak që dëgjon fjalën tënde dhe çfarë është shkruar.

Mitat Daja . Thjesht pyeta për informacion .



Ervis Shera . Ka mbledhje që zgjasin 2 orë dhe procesverballi shkon 50 faqe. Sekretari i këshillit ka 10 ditë kohë për zbardhjen e procesverballit të mbledhjes së këshillit, në qoftë se e don brenda këtij 10-ditëshi mund të ja çojmë të gjithë këshilltarëve.

Mitat Daja . Mundësisht kështu duhet të funksionojë sepse edhe ne ta dimë se për 1 muaj harrohen gjërat, flasim për mbledhjen e radhës.

Ervis Shera . Është gjë që realizohet, hapim një grup të këshilltarëve në whatsapp.

Mitat Daja . Në rregull brenda afateve kohore i shikojmë kontrollojmë, kujtohem edhe vetë e të gjitha. Gjendet zgjidhja nuk është se nuk ka zgjidhje kjo punë. Mbarova kaq kisha.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim, miratimin e procesverballit. Pro, kundër, abstenim? Miratohet.

-Miratohet me 16-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Shqyrtim i kërkesës për dorëheqje nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak të znj. Sadete Kaja. Atëherë fjala për ju do relatojë z. Shpati Kolgega kryetar i komisionit të mandateve. Fjala për ju z. Shpati.

Shpati Kolgega . Faleminderit. Atëherë mbledhje e mbajtur sot më datë 29.06.2023, në mbledhjen për shqyrtimin e dorëheqjes nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Sadete Kaja.

Nga verifikimi i dokumentacionit, komisioni vërtetoi që Këshilltarja znj. Sadete Kaja e renditur e katërta në listën shumëemërore për këshilltarë të subjektit politik “Bashkë Fitojmë” për arsye personale ka paraqitur një kërkesë për dorëheqje nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 49, neni 55 pika 3, të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Rregullores “Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”,

I propozojmë këshillit bashkiak të pranojë dorëheqjen e znj. Sadete Asllan Kaja nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim propozimin e komisionit të mandateve për pranimin e dorëheqjes nga mandati i këshilltares znj. Sadete Kaja. E hedhim në votim. Kush është pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.



-Miratohet me 16-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr .7. Miratohet me 16 vota pro, propozimi i Komisioni të Mandateve, Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të znj. Sadete Kaja.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, Miratim i Komisioneve të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë. Këshilli Bashkiak mbështetur në Rregulloren e tij të ketë 6-të, Komisione të përhershme të përbërë me nga 5 - anëtarë secili (përfshirë Kryetarin e Komisionit dhe Zëvendësin e tij), të cilët janë si më poshtë :

1.Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit.

Kryetarët e grupeve do të propozojnë emrat. Jemi tek komisioni i parë, z. Enver.

Enver Memolla . Faleminderit Kryetare. Përshëndetje të gjithëve! Fillimisht ne kemi maxhorancën e komisionit?

Mukades Gixhari . Po.

Enver Memolla . Alime Hoxha, Enver Memolla, Gezime Met-hasani. Për komisionin e Financës, Taksave dhe Revizionimit.

Mukades Gixhari . Atëherë këto 3, Kryetar Alime Hoxha, Anëtar z. Enver Memolla dhe znj. Gezime Met-hasani.

Hekuran Xhani . Të konsultohemi se ne jemi shumë parti. Me leje një zëvendëskryetar dhe 1 anëtarë kemi?

Mukades Gixhari . Po tek njëshi, tek financa.

Hekuran Xhani . Po tek shëndetësia që t'i përcaktojmë qartë ...

Mukades Gixhari . Qëndro po aty që ta diskutosh me kolegët. Mirë ...

Sokol Gosa . Mbaro me të parën pastaj filloji me radhë.

Hekuran Xhani . Bajazit Thaçi, zëvendëskryetar, Indrit Dedej anëtar.

Mukades Gixhari . Në rregull, kalojmë në komisionin e dytë, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit,



Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit. z. Enver.

Hekuran Xhani . Zëvendëskryetar Sokol Gosa.

Sokol Gosa . Një minutë të flasi Veri.

Enver Memolla . Për sa i përket komisionit të Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit partia socialiste propozon kryetar z. Erind Tosku, anëtar Renato Kalemi, anëtar Fatmira Thartori.

Mukades Gixhari . Hekuran Xhani, fjala për ju.

Sokol Gosa . Kryetare unë dëgjova z. Enver me propozimet e tij por mendoj që në këtë komision ku përfshihen disa fusha ku kam dhënë një kontribut siç është arsimit, kultura apo edhe sporti duke përjashtuar shëndetësinë, mendoj që të na e kaloni në këtë komision për kryetar. Tani në qoftë se gjejmë mirëkuptimin edhe të pozitës, këto janë argumentet e mia që mund të përjashtojnë...

Mitat Daja . Ska kuptim që të mos gjendet mirëkuptimi Koli njihet si mësues, futbollist tani tejkalojini pak ato...

Hekuran Xhani . Nëse kemi komision tjetër mund ta këmbëjmë, në rast se do i jepni kryetarin opozitës.

Erind Tosku . Nuk ka problem kaloj unë nënkryetar.

Sokol Gosa . Faleminderit.

Enver Memolla . Përderisa zotëria që unë propozova z. Erind Tosku e pranon . Atëherë Sokoli nga opozita Kryetar dhe propozimi im si kryetar kalon si zëvendëskryetar i komisionit. Në rregull?

Sokol Gosa . Faleminderit.

Enver Memolla . Punë të mbarë dhe komisionit.

Hekuran Xhani . Atëherë kryetar Sokol Gosa dhe anëtare Besnike Coraj.



Mukades Gixhari . Vazhdojmë me komisionin e tretë , Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave. Propozimi juaj z. Enver.

Enver Memolla . Atëherë për këtë komision kryetar z. Lulzim Hasa, anëtar Fatmira Thartori, anëtar z. Altin Tosku subjekti politik PSD aleati i PS.

Mukades Gixhari . Po z. Hekuran propozimi juaj kush është?

Hekuran Xhani . Zëvendëskryetar Ferdi Avdiu, anëtar Hekuran Xhani meqë unë vi nga fusha e bujqësisë.

Mukades Gixhari . Kalojmë në komisionin e katërt, Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infstrukturës.

Enver Memolla . Atëherë kryetar Shpati Kolgega, anëtar Renato Kalemi, kam një pjesë për bashkëpunim për anëtarin e pavarur z. Mitat Daja.

Mitat Daja . Jo nuk ...

Enver Memolla . Në rregull atëherë Gezime Met-hasani.

Mitat Daja . Për sqarim gjënë time. Unë jua thashë dhe në fillim para se të fillonte mbledhja e pakta gjë edhe kur fola për Sokolin ne këtu duhet të tejkalojmë disa gjëra nuk është puna me bërë qokat e njëri tjetrit ju këtu që jeni shumicë. Dakord ju jeni maxhorancë unë jam i pavarur por duhet të ekzistojë një respekt edhe për të tjerët që kanë marrë pjesë në këtë këshill dhe nuk i ka falur asnjë asgjë, e kanë marrë vetë. Kur ju doni t'i merrni kryetar zëvendëskryetarin e gjithë ato të tjerat mbajini për vete t'i gëzoni bëhuni dhe anëtrë po deshët përveçse kryetar dhe zëvendëskryetar. Po nuk respektuat jua kthejmë respektin ashtu siç duhet, po na respektuat ju nderojmë . Unë me këto anëtarë e kështu mbajini për vete bëni çfarë të doni unë nuk marr pjesë si anëtar. Jam i pavarur njerëzit që më kanë votuar do t'i respektoj duke i nderuar me prezencën time këtu, ndoshta shumica prej jush nuk ka dashur që të jem këtu por se njerëzit deshën që unë të jem këtu. Nëse do vazhdoni kështu nuk jeni në rregull. Dakord ti Enver meqë je kryetari i grupit të PS-së ? Edhe të njëjtën këshillë kam dhe për grupin tjetër, jeni grupe vazhdoni mund t'i merrni edhe anëtarët edhe kryetarët bëni çfarë të doni vetë të gjithë. Dakord?! Kaq kisha unë për komisionet e juaja.

Mukades Gixhari . Po znj. Silvana.



Silvana Aliu . Besoj se nuk e keni për grupin tonë Mitat.

Enver Memolla . Unë përpara mbledhjes takova...

Mitat Daja . Unë nuk kërkoj komisionet që caktoni ju, komisionet që më takojnë. Komisioni i rëndësishëm në Bashki nuk është komisioni që më caktoni ju anëtar, është komisioni që unë dua të jem se kam ardhur këtu jo thjeshtë për të marrë 80-mijë lekë rrogë kush e quan rrogë këtë, kam ardhur këtu që të kontribuoj për të mirën e qytetit, tek financat e qytetit, tek taksat e qytetit, tek punësimi i qytetit. Dhe nëse ju nuk e keni kuptuar këtë gjë ky është qëllimi im që kam ardhur këtu nuk kam ardhur këtu thjeshtë për t'u ulur e për të ngrohur karriken e as t'i bëj fresk askujt.

Enver Memolla . Mund të përgjigjem? Atëherë me gjithë respektin unë sapo ta thashë dhe të propozova ... për sa i përket pjesës dhe anëtarët që grupi i PS ka propozuar janë të fushës në ato komisione nuk janë jashtë funksioneve. Edhe marrëveshja që bëmë për z. Sokol edhe Sokoli edhe Erindi janë të dy mësues kjo ishte marrëveshje...

Mitat Daja . Kjo ishte marrëveshje e pëlqyer pra... pse thashë këtë e kaluat shumë bukur... tejkaloni mos u bëni kaq striktë, kaq fanatikë sepse nuk po ju merr njeri gjë, hajde të diskutojmë gjëra që janë të rëndësishme.

Enver Memolla . Tani unë thashë në respekt tënd të erdha ta bëra propozimin, si kryetar grupi dhe ju refuzuat vetë komisionin.

Mitat Daja . Propozimi yt i dashur Enver është propozim që nuk më përshtatet projekteve të mia në këshillin bashkiak. Nuk kam ardhur këtu që të bëj opozitën për të penguar punët kam ardhur këtu që të kontribuoj që punët të bëhen më mirë. Në rregull? Kjo është ajo që mendoj unë nuk shkoj atje ku don ti apo do dikush tjetër unë shkoj atje ku kam projektin tim nëse aprovohet po, nëse jo shihni punën tuaj. Ju jeni shumica dhe ju vendosni, ju keni votat.

Enver Memolla . Atëherë propozimet e mia janë ato që ishin. Siç e thashë Shpati Kolgega, Renato Kalemi dhe Gezime Met-hasani. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Enver. z. Hekuran emrat tuaj.

Hekuran Khani . Atëherë zëvendëskryetar Saimir Cani dhe anëtare vendi i mbetur bosh për zëvendësimin e radhës që do bëhet për znj. Sadete Kaja.



Mukades Gixhari . Vazhdojmë me komisionin nr.5, Komisioni Juridike, Rend, Konflikte. Z. Enver.

Enver Memolla . Atëherë për këtë komision Renato Kalemi, Lulzim Hasa dhe Erind Tosku.

Mukades Gixhari . z. Hekuran propozimet tuaja.

Hekuran Xhani . Zëvendëskryetar Indrit Dedej dhe anëtar Bajazit Thaçi.

Mitat Daja . Kisha unë diçka këtu për këtë komisionin Juridik, Rend, Konflikte. Unë ja propozova kur i thashë Verit si kryetar i grupit të PS unë mendoj që ky komision duhet të shikohet pak më ndryshe dhe prandaj kam propozuar veten time këtu tek ky komision sepse një person i cili merret me fenë ka mundësi që të zgjidhë edhe konflikte. Kështu që ju shikoni mundësinë nëse pranoni të dy grupet që unë ta drejtoj këtë komision unë jam dakord nëse nuk pranoni është puna juaj. Të jem kryetar i këtij komisioni sa herë që të ketë konflikte të jem i pranishëm që të zgjidhim konfliktet e njëri tjetrit mos t'i lejmë njerëzit aq sa kanë për 30 vjet në konflikt dhe nuk kanë zgjidhur akoma asnjë lloj konflikti, unë nuk pretendoj që do marr shkopin magjik e do ndryshoj por do mundohem që të jem zgjidhës i konflikteve.

Enver Memolla . Atëherë znj. Kryetare tani e pashë ndjesë atëherë kërkoj ndryshim propozimi për kryetarin duke tërhequr Erind Toskun nga Komisioni z. Renato Kalemi kalon anëtar dhe Mitat Daja Kryetar i këtij komisioni.

Mitat Daja . Shumë faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit për mirëkuptimin.

Erind Tosku . Hajde punë të mbarë !

Mitat Daja . Faleminderit, na përdortë Zoti për gjëra të mira kjo është arsyeja kryesore.

Hekuran Xhani . Jemi dakord të dy grupet.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek komisioni tjetër.

Hekuran Xhani . Për procedurë, tani nisur nga ndarja e komisioneve . I propozoj grupit të maxhorancës që ky komision të jetë kryetare Silvana Aliu me mirëkuptim me konsensus. Për të bërë një ndarje serioze.



Shpati Kolgega . Bëmë shumë konsensusë sot kështu që mos ta prishim deri në fund.

Hekuran Xhani . Ju faleminderit.

Mukades Gixhari . Ju faleminderit për bashkëpunimin. Atëherë do fillojmë me z. Hekuran.

Hekuran Xhani . Faleminderit grupit të maxhorancës kryetarit të grupit dhe gjithë anëtarëve të këshillit për mirëkuptimin propozoj si kryetare e komisionit të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale znj. Silvana Aliu dhe anëtare zëvendësuesen që do vijë sipas radhës të znj. Sadete Kaja.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Hekuran. z. Enver propozimet tuaja?

Enver Memolla . Atëherë kryetare për sa i përket këtij komisioni në bashkëpunim dhe në marrëveshje me opozitën zëvendëskryetare e këtij komisioni znj. Fatmira Thartori, anëtare Alime Hoxha dhe anëtri tjetër Fatbardha Sina partia socialdemokrate aleate. Faleminderit ju shkoftë mbarë.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Enver. Tani t'i lexojmë të gjithë komisionet që sapo i zgjodhëm nga dy kryetarët e grupeve dhe pastaj do t'i hedhim në votim të gjitha bashkë.

1. Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit

- | | | |
|---------------|------------|-----------------|
| - znj. Alime | Hoxha | Kryetare |
| - z. Bajazit | Thaçi | Zëvendëskryetar |
| - z. Enver | Memolla | Anëtar |
| - znj. Gezime | Met-hasani | Anëtare |
| - z. Indrit | Dedej | Anëtar |

2. Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit.

- | | | |
|----------------|----------|-----------------|
| - z. Sokol | Gosa | Kryetar |
| - z. Erind | Tosku | Zëvendëskryetar |
| - z. Renato | Kalemi | Anëtar |
| - znj. Fatmira | Thartori | Anëtare |
| - znj. Besnike | Coraj | Anëtare |

3. Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave.

- | | | |
|-------------|------|---------|
| - z. Lulzim | Hasa | Kryetar |
|-------------|------|---------|



- z. Ferdi Avdiu Zëvendëskryetar
- znj. Fatmira Thartori Anëtare
- z. Altin Tosku Anëtar
- z. Hekuran Xhani Anëtar

4. Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infstrukturës.

- z. Shpati Kolgega Kryetar
- z. Saimir Cani Zëvendëskryetar
- z. Renato Kalemi Anëtar
- znj. Gezime Met-hasani Anëtare
- *Kandidati që do të zëvendësojë*
znj. Sadete Kaja Anëtar

5. Komisioni Juridike, Rend, Konflikte.

- z. Mitat Daja Kryetar
- z. Indrit Dedej Zëvendëskryetar
- z. Lulzim Hasa Anëtar
- z. Renato Kalemi Anëtar
- z. Bajazit Thaçi Anëtar

6 . Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale

- znj. Silvana Aliu Kryetare
- znj. Fatmira Thartori Zëvendëskryetare
- znj. Alime Hoxha Anëtare
- znj. Fatbardha Sina Anëtare
- *Kandidati që do të zëvendësojë*
znj. Sadete Kaja Anëtar

Mukades Gixhari . Duke ju falenderuar për mirëkuptimin. E hedhim në votim komisionet. Pro, kundër abstenim? Të gjithë pro. Miratohet. Faleminderit.

- *Miratohen me 16- vota pro komisionet e përhershme të këshillit bashkiak Rrogozhinë sipas propozimeve të bëra nga këshilltarët dhe grupet politike.*

Vendim nr .8. Miratohen me 16- vota pro Komisionet e përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë (6-të në total) me përbërje sipas propozimeve dhe konsensusit të gjetur mes



Këshilltarëve dhe grupeve politike, si më lart.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Përgjegjësi i zyrës së Mirëqënies Sociale z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian, fjala për ju.

Ledian Hasani . Përshëndetje të gjithëve dhe ju ectë mbarë! Në total janë 24-familje që janë përfituese dhe fondi është 90 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Keni ndonjë pyetje?

Hekuran Xhani . Emrat ku i keni?

Ledian Hasani . I keni tek projektvendimi ka njësia Gosë, Kryevidhi, Lekaj. Këto janë familje që duhet të vijnë tek zyra e ndihmës ekonomike e të aplikojnë për ndihmë në qoftë se dalin përfitues dalin në qoftë se nuk dalin pastaj... 6 % e fondit total. Janë përzgjedhur në bazë të kriterëve nuk është se vijnë aty dhe i fusim ... është ngritur një komision nga bashkia.

Mitat Daja . Led këtu janë 24 familje tek një tjetër janë 12. Janë ndryshe?

Ledian Hasani . Është moment tjetër. Këto janë fonde të Ministrisë që ta keni të qartë që në fillim nuk janë fonde të Bashkisë është fond që na e sjell ministria është fiks si fond dhe nuk mundemi ne që ta tejkalojmë si fond, pastaj tek projektvendimi tjetër flasim dhe aty diskutojmë. Këto familje duhet të aplikojnë tek zyra e ndihmës ekonomike, i kemi informuar të gjithë familjet. Tek projektvendimi tjetër diskutojmë ky është fondi që është i kufizuar dhe familjet kanë kriterë shumë të forta për t’u kualifikuar. Tjetra është e bashkisë nuk është e ministrisë.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16-vota pro, pika pesë e rendit të ditës.

Vendim nr .9. Miratohet me 16 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2226.Prot datë 20.06.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën gjashtë të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit,



“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. z. Ledian fjala për ju.

Ledian Hasani . Gjithsej janë 12 familje që janë përfituese dhe fondi është 40 mijë lekë të reja .

Mitat Daja . Ky fond është i përcaktuar Led është i kufizuar apo ka...?

Ledian Hasani . Fondi për këto përcaktohet kur miratohet buxheti, dmth kur të vijë buxheti në Dhjetor aty diskutojmë për këtë pjesën se sa fonde do kemi për 2024.

Mitat Daja . Është një emër këtu në fund që është bërë dhe operacion.

Ledian Hasani . Po, Enver Hyseni.

Mitat Daja . Po. Është mundësia që të bëhet diçka më shumë për këtë? Se nuk e kam idenë se si funksionon për të bërë diçka më tepër se sa kjo shumë që është vendosur këtu?

Ledian Hasani . Për momentin jo.

Mitat Daja . Atëherë të gjendet mundësia që të futet muaj pas muaji.

Ledian Hasani . Aty e kemi vetë në dorë pastaj.

Enver Memolla . Led edhe një pyetje për këto që përfitojnë ndihmë ekonomike nga pjesa e Bashkisë nga fondet e bashkisë a mund të jenë përfitues edhe për ndihmën e menjëhershme?

Ledian Hasani . Po për këtë po diskutojmë, për momentin nuk mund t’i kalojmë. Shikoni dhe këto emrat në qoftë se keni për ndonjë emër që nuk e meriton.

Besnike Coraj . Pjesa më e madhe janë nga Bashkia Rrogozhinë.

Ledian Hasani . Ka edhe nga Kryevidhi.

Besnike Coraj . Është vetëm një person, një familje.

Ledian Hasani . Ato kanë bërë kërkesë, herë të tjera ka pasur Gosa ka pasur Lekaj, Sinaballaj kanë pasur dhe njësitë jo vetëm Rrogozhina.



Enver Memolla . Tani për t' u qartësuar për këshilltarët që janë të rinj, se ne jemi këtu dhe nga viti i kaluar duke ditur që këto do zëvendësohen nuk janë të përhershëm.

Ledian Hasani . Këto lista nuk janë të përhershme.

Enver Memolla . Plus kush është njeri që e njih dhe me të vërtetë është nevojtar mund të drejtohet tek zyra e ndihmës ekonomike në bashki, pastaj kriteret janë në rregullore dhe ligj.

Ledian Hasani . Ne zakonisht i verifikojmë nëpër shtëpi, shikojmë edhe gjëndjen socialekonomike të personit, jo çdo kush që kërkon miratohet. Atë shumë parash do ta marri dikush që e meriton që plotëson kriteret.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër për ndihmën ekonomike nga fondi i pushtetit vendor?

Hekuran Xhani . Tani ne jemi përfaqësuesit qytetarët e Bashkisë Rrogozhinë këtu, jemi këtu për të mbrojtur interesat e atyre për zgjidhjen e halleve dhe problemeve, tani unë mendoj që kjo lista duhet të zgjerohet duke u nisur nga gjendja ekonomike dhe çdo njësi administrative ka punonjësin e vet.

Ledian Hasani . Kemi pasur raste që ka pasur më shumë nga Gosa po themi.

Hekuran Xhani . Unë kurrë nuk paragjykoj që mund të ketë tre nga Kalushi dhe mos ketë asnjë Luzi për mua të shkojë haku tek i zoti, pra të marri ai që e meriton. Problemi është që unë mendoj që kjo listë duhet shtuar duke u nisur nga gjendja reale dhe pikërisht unë flas për fshatin tim, herën tjetër ne të gjithë bashkë le të vijmë këtu dhe në fund të fundit ta kemi dhe një mision humanitar për njerëzit në nevojë ato njerëz që ne mendojmë ose t'i adresojmë pranë njësisë administrative ose dhe emrat dhe ju mund të bëni verifikim pastaj t'i shërbejmë të gjithëve.

Ledian Hasani . Verifikim do i bëhet të gjithëve.

Hekuran Xhani . Unë jam plotësisht dakord me nismën sot ta votojmë .

Enver Memolla . Kjo listë varet nga buxheti që kemi miratuar ne në Dhjetorin e kaluar dhe kjo listë tani për pjesën e fondit ne si komisioni i financës që është ngritur në rakordim me financën e bashkisë duhet të marri të dhënat se sa janë të ardhurat e bashkisë se këto janë fondet e bashkisë nuk janë nga ministria të deleguara dhe në bazë të fondit që kanë aq më mirë më shumë njerëz. Kjo është pjesë që ne e kemi në dorë për të bërë pjesën humanitare që tha dhe z. Xhani, kjo varet



nga të ardhurat e bashkisë Rrogozhinë për këtë marr shkas sepse kam qenë dhe vetë kryetar komisioni të ekonomisë në mandatin e kaluar dhe varet nga të ardhurat e bashkisë. Nga ana jonë biem dakordësi që njerëzit që janë në nevojë t'i ndihmojmë. Vetëm një gjë kërkoj nga zyra e ndihmës ekonomike dhe sociale që bashkëpunimi me zyrën e punës sepse mesa di ka kërkesa për punë t'i adresoni se mund të ketë njerëz të bëjnë punë aty ku është sidomos tani sezonin e verës pjesa turistike sepse po merren njerëz nga Cerriku dhe po shkojnë në Spille, këtë pjesë ma kini pak...

Ledian Hasani . Kemi bashkëpunuar me zyrën e punës.

Enver Memolla . Ideja është edhe kjo pjesa tjetër që edhe njerëzit mos të mësohen me atë 17 mijë lekëshin 10 apo 30 mijë lekëshin edhe njerëzit të punësohen se punësimi ka edhe të mirën e pagës edhe siguracionet dhe mund të jetë i aftë për një punë dhe për këtë pjesë unë kam kontakte...

Mitat Daja . Për këtë duhet të bëjë sensibilizim bashkia për punësim njerëzish, sepse ato që vijnë nga ndihma ekonomike e kanë mendjen tek ndihma nuk e kanë mendjen tek puna Bashkia, zyra e punës të sensibilizojë njerëzit për punësim. Të gjejë mënyrate e veta, Bashkia duhet të gjejë format se si t'i rregullojë njerëzit jo thjeshtë vetëm t'i punësojë t'i çojë aty ku duhet me punuar dhe të ofrojnë shërbimin, kjo është ajo që duhet bërë.

Ledian Hasani . Në qoftë se një person është nevojtar dhe mundësia është nga ana jonë ai do ta marri ndihmën ekonomike.

Indrit Dedej . Kam një rast që ajo nuk ishte në dijëni që ishte në punë, shkuam ta regjistrojmë në shkollë shkuam tek zyra e punës me marrë vërtetimin ajo s'dinte që ishte në punë në bashki.

Ledian Hasani . Po flas për ndihmën ekonomike.

Indrit Dedej . Po flas për punën për punëtorët nuk po flas për ndihmën nuk merr kurajon tjetri se do thotë ti je i bardhë ti je i zi, prandaj të jemi praktik...

Fjala e Këshilltarit Indrit Dedej nuk është zbardhur e plotë për shkak se në materialin audio video të mbledhjes dëgjohet shumë dobët.

Erind Tosku . Ajo nuk e dinte që ishte në punë?

Indrit Dedej . Nuk e dinte.



Mukades Gixhari . Në lidhje me pikën 6-të të rendit të ditës e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 vota pro pika gjashtë e rendit të ditës.

Vendim nr .10. Miratohet me 16-vota pro, projektvendimi ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.2302.Prot datë 30.06.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Ledian. Jemi tek pika 7-të tek të ndryshme, tani çfarë keni ndonjë gjë për të diskutuar, ky është momenti .

Mitat Daja . Meqë është dhe financa këtu drejtori i financës. A është mundësia për të rishikuar këtë punën e ndihmës ekonomike që të ketë pak më tepër ... se shoh psh 1800 lekë një familje. Unë i njoh meqë janë në Rrogozhinë i njoh këto emra se 1800 lekë nuk është se mund ta quash ndihmë nuk mund ta quash dot as kafshatë këtë 1800 lekëshin.

Rezart Vogli . Atëherë në radhë të parë ju uroj punë të mbarë të gjithëve uroj të kemi një bashkëpunim sa më të mirë 4-vjeçarin e ardhshëm.

Mitat Daja . Nuk e kam mbaruar akoma. Bashkëpunimin do ta shikojmë në vazhdim.

Rezart Vogli . Foli Ledi pak më parë por do të jua shpjegoj dhe unë pjesën e ndihmës.

Mitat Daja . Po, nuk mund të rishikohen? Ledi është ndihma ekonomike kurse ju jeni financa. Se kjo shumë nuk del për kafshatë buke për gjithë muajin. Ma shpjego kërkoj vetëm informacion.

Rezart Vogli . Z. Mitat e kam si natyrë që gjithmonë mbledhjet e këshillit bashkiak rri, kam s’kam çështje diskutoj me sekretarin më informon dhe vi. Ndihma ekonomike 3% funksionon zanafillën e ka në formimin edhe në krijimin e projektbuxhetit të vitit pasardhës, ku gjatë diskutimit referuar viteve paraardhës parashikohet një fond, ky fond përbëhet për këtë skemën 3 % . Skema 3% ka të bëjë me aplikantët që aplikojnë për ndihmë ekonomike ose për 6% që është një fond që vjen nga ministria e linjës dhe kërkuesit që nuk e përfitojnë ndihmën ekonomike në bazë të sistemit të pikëzimit ne i referojmë edhe i mundësojmë këtë ndihmën 3% që ndryshon çdo tre muaj në varësi të rastit se rasti ndryshon. Duhet më shumë, hajde ta diskutojmë.



Mitat Daja . Unë ta mora shembull një person që ka prerë këmbën ta mora shembull...

Rezart Vogli . E kam parasysh rastin.

Mitat Daja . 40 mijë lekë atij nuk i bëjnë gjë, 18 mijë lekë atij personit tjetër që ke shkruar këtu nuk është asgjë pra për këtë po flasim. Marrim një shembull janë 12 deri në 6 të marrin diçka më tepër.

Rezart Vogli . Gjatë ndihmave diskutojmë edhe rastet të ndihmave të menjëhershme, i referohemi 30 mijë deri 50 mijë në varësi të rastit. Rasti shqyrtohet dhe analizohet zakonisht i adresohet administratorit të zonës, kryepleqtë, banorët tek anëtarët e këshillit bashkiak që i njohim. Ka dhe raste të tilla që i ofrohet ndihma e menjëhershme.

Mitat Daja . Unë mendoj që më shumë anëtarët e këshillit bashkiak duhet të merren me këtë punë sepse administratorët dhe kryepleqtë kanë dështuar që të sjellin raste serizoe për t'i ndihmuar. Me atë që kam parë deri tani.

Erind Tosku . Mitat më fal, asnjëri nga ne nuk është kundra për të dhënë ndihmë ekonomike.

Mitat Daja . Anëtarët e këshillit thashë kurse administratorët dhe kryepleqtë më shumë kanë dështuar.

Erind Tosku . Anëtar këshilli jam dhe unë por po them që ne anëtarët e këshillit edhe mandatin e shkuar kemi dhënë ndihma kur nuk ka patur mundësi për të kryer aktin funeral të familjarit.

Mitat Daja . Mos diskutojmë për mandatin e kaluar po flasim për tani.

Erind Tosku . Po të them një sqarim nuk jemi kundra asnjë nga ne për të dhënë ndihma s'është asnjëri nga ne për të dhënë më shumë asnjërit. Ka një kriter financa gjithashtu thashë dhe njëherë kemi pasur dikush nga këto me ndihmë të menjëhershme por nuk mund të jetë më herës që kaloi ikën ai, vjen dikush tjetër.

Mitat Daja . Si fillestar që jamë unë pyetja që i drejtoj financës s'ke pse të mërzhitesh ti është që 1800 lekë ja vlen ta marri ky njeri apo nuk ja vlen këtë pyetje drejtoj. Për këtë unë fillestar jam më sqaroni.

Erind Tosku . Po na bën ne sikur ne po i marrim të gjithë lekët për vete dhe nuk po i japim njerëzve ndihmë.



Mitat Daja . Nuk tha njeri këtë mos e ngatërro.

Erind Tosku . Po kështu po i jep konotacion.

Mitat Daja . Mos i ngatërro gjërat nuk jam pjesë akuze unë thjesht po bëj pyetje. Kush të tha ty që po merr ndihma? Nuk thashë gjë fare që po merr njeri i drejtova pyetje dhe përgjigjen ma dha Rezi përgjigjen kaq është pyetja ime, mora përgjigjen do pyes prap herë tjetër. Ka ndonjë problem të pyes?

Erind Tosku . Jo pyet. Thjeshtë mos i jep ngjyrë të gabuar sikur ne nuk duam me ndihmuar.

Mitat Daja . Kush e tha këtë...?! Nuk thashë gjë...

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Sa për të ndërhyrë pak unë pak më parë dhe për emrin që z. Mitat përmendi, ja cilësova dhe zotërisë së ndihmës ekonomike procedurën e ndihmës së menjëhershme dhe përgjigja ishte që aktualisht nuk mund ta ndihmojmë. Zotëria do kontaktohet me anëtarët e këshillit të Rrogozhinës të interesohet pranë bashkisë Rrogozhinë si të ndjekë këtë procedurë. Edhe mandatin që kaloi edhe këtë mandat që jemi bashkë askush nga ne këtu nuk ka qenë ndonjëherë kundër ndihmës ekonomike. Për sa i përket pjesës 1800 lekë nuk jemi ne anëtarët e këshillit që e vendosim atë shumë është një komision që merret me atë zyra e ndihmës ekonomike që e përcakton atë. Dhe personi që e përfiton atë e firmos dhe e pranon atë 1800 lekësh nuk është se i jepët me zor...

Altin Tosku . Mos e pranojë fare.

Enver Memolla . Nëse nuk e pranon pastaj nuk futet fare. Prandaj thashë dhe qëparë duhet të ngrihet klima dhe puna me pjesën e bashkisë nga zyra e punës që t'i çojë njerëzit t'i punësojë në privat për këtë pjesë. Kurse pjesa e ndihmës ekonomike nuk ka asnjë person kundër nga ne që ta ndalojë.

Mitat Daja . Për sqarim që të sqaroj dhe Erindin dhe të gjithë. Nuk hodha kurrë asnjë lloj dyshimi që ndihma ekonomike po abuzohet etj. Thjeshtë pyetja që drejtova ishte shumë e sinqertë dhe shumë serioze. A është mundësia që të shtohet? Nuk kishte lidhje as për emrat kjo ishte pyetja që unë drejtoj.



Enver Memolla . Thashë që varet nga fondet e bashkisë.

Mitat Daja . Kjo ishte pyetja nuk tha njeri që është abuzuar.

Silvana Aliu . A është mundësia që bashkia të bashkëpunojë me biznesin sepse ka persona që marrin ndihmë ekonomike të shkojë të punësohet. Problemi është punësimi.

Mitat Daja . Ne kemi një institucion që është xhamia dhe ndihmon më shumë njerëz se sa ndihmon bashkia nuk është normale kjo.

Erind Tosku . OJF ka sa të duash Mitat.

Mitat Daja . Një minutë, me kontribute vullnetare dhe jo me fonde shteti, kështu që duhet të merren gjërat seriozisht dhe jo thjeshtë për të kaluar.

Erind Tosku . Në bazë të bashkëpunimeve Bashkia me OJF ka ndihmuar familje në nevojë tani mos na bëj sikur nuk kemi bërë gjë.

Mukades Gixhari . Z. Enver do japë një mendim.

Enver Memolla . Meqenëse jemi dhe në pikun e sezonit turistik në mbledhjen e ardhshme i pranishëm këtu të jetë përgjegjësi i zyrës së punës Rrogozhinë për të dhënë një informacion se sa vende pune janë dhe çfarë profesioni përcakton kjo pjesë që edhe ne të gjithë. Që edhe ne t'i drejtohem zyrave të Bashkisë dhe të themi që këto vende pune janë bosh dhe të gjejmë njerëzit .

Hekuran Xhani . Shumë e drejtë.

Silvana Aliu . Ka biznese brenda Rrogozhinës që kërkojnë edhe nuk shkojnë.

Enver Memolla . Sapo e thashë nuk duhet të imponojmë për të futur njerëz në ndihmë ekonomike, ne t'i imponojmë njerëzit të shkojnë në punë. Se në punë do marrin dhe pagën do marrin dhe siguracionet se nesër do ketë dhe pension kur t'i vijë moshë.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Z. Sokol.

Sokol Gosa . Zonja kryetare unë kisha disa pyetje apo diskutime meqë është dhe drejtori i financave këtu. Në lidhje me fondet që ka Bashkia jonë apo më mirë me numrin e punonjësve, sa



është? Të paktën këtë informacion duhet ta kishim, në këtë rast. Sa harxhohet pra nga granti që marrim një shifër 100-500-600. Po Rezi mund ti shënosh. A janë të gjithë në Rrogozhinë? Kjo është dhe e verifikueshme.

Rezart Vogli . Flasim a janë aktualisht në Shqipëri?

Sokol Gosa . Po, janë në Rrogozhinë nëpunësit, flasim për të gjithë punonjësit e Bashkisë. Janë efikasë në pozicionet e tyre të punës? Janë efikasë se shikojmë që vijnë aty paraqiten dy orë në ditë dhe ikin në punët e tyre private e me radhë. Një minutë Rezi të lutem ta mbaroj dhe pastaj mund të diskutosh. U diskutua dhe për pikun e sezonit që jemi tani, ne kemi problem që nga qendra e qytetit apo dhe hapësirat që janë publike, që duhen rishikuar apo duhen marrë masa urgjente për dezinfektimin ndoshta duhej të ishte bërë më përpara dezinfektimi, apo dhe pastrimi sidomos tek parku NISH Vaji i dikurshëm është një... që mua më vjen keq turp ta them, vend ku njerëzit ... është tmerr. Këtë e kam urgjente Rezo sidomos me ndërtesat e NISH Vajit. Se çfarë masash mund të merrni për këtë periudhë unë i kam thënë edhe Olsit me e mbyllur urgjent me mur. Ai vuri vetëm ato rrethimet çfarë i bëri por nuk ishte zgjidhje, është turp turp, janë kthyer në banjo publike në mes të qytetit në çdo orë të ditës është skandal i madh. Do thuash ti profesor e ke aty shtëpinë dhe ... Jo jo nuk ka gjë më të rëndë vijnë goca, vijnë zonja vijnë kalojnë hyjnë burra çuna dhe sikur po shkojnë... skandal.

Shpati Kolgega . Më fal për ku po flasim?

Sokol Gosa . Tek ndërtesat Shpati.

Shpati Kolgega . Mbrapa parkut?

Sokol Gosa . Tek barakja e Çelikut aty është, sa hyn aty është... Dhe ku në mes të qytetit dhe larg po të ishte sërish ... Plus pastaj dhe për sezonin e plazhit mundësitë që mund të ketë po Bashkia punësimi do të ishte një investim për ato familje që ne sapo diskutuam. Besoj se ka hapësira ka forma të ndryshme edhe punësime mund të ketë dhe sezonale se kemi bërë dhe sezonale sa të duash të jenë të paktën efikasë. Të shkojnë aty familje që janë vërtetë në nevojë si mund të shkojë roje plazhi pastrues plazhi që është marshalla i shëndetshëm dhe të marrë atë rrogë 200-300 sa do marri. Kur një tjetër që është me të vërtetë fukara dhe ka shumë nevojë për ato pak lekë për një muaj dy muaj në këtë prizëm. T'i lejmë mënjane ato kur i thonë çështjet partiake apo punësimet partiake kur është mundësia mund të bëjmë diçka të mirë edhe për ato. Unë me këtë parim isha edhe në fillim të mbledhjes që e kërkova atë dhe gjeta mirëkuptimin edhe të ... vërtetë u treguat xhentëllmenë në këtë aspekt do jua di për faleminderit për



mirëkuptimin. Kështu dua që ta kalojmë edhe këtë 4-vjeçar që do jemi së bashku, në qoftë se gjendet gjuha e mirëkuptimit bashkëpunimit atëherë hajde bëjmë punë të mira për këtë qytet. Ky është parimi im të punojmë për këtë qytet, ju faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Sokol . Po z. Shpati.

Shpati Kolgega . Në vazhdim të asaj që tha profesori duke qenë se në jemi këshill i ri, ku shumë nga ne janë për herë të parë. Duke qenë se ne jemi një organ që nuk jemi organ ekzekutiv në kuptimin e drejtimit të punëve pra bërjes së punëve fizike do doja që mbledhjen e ardhshme duke qenë se u ngritën dhe shqetësime. Por besoj se shumë nga ne përfshirë dhe unë kam shumë çështje për të ngritur por këtu nuk kemi personat kompetentë që mund të na japin përgjigje siç është Rezi sot kemi vetëm Rezin që është drejtor i financës. Do doja që mbledhjen e ardhshme, do propozoja në qoftë se ju do jeni dakord që të kishim këtu mbledhjen e ardhshme për diskutime për çështje të ndryshme veç rendit të ditës edhe drejtorët e bashksië, përgjegjësit e sektorëve, administratorët e njësive administrative në mënyrë që ne këto probleme që kemi sot pra atë që tha Sokoli qëparë pa një person që të na japë një përgjigje të japë një afat të thotë po mund të bëhet mund të mos bëhet ka buxhet nuk ka buxhet duhet të jenë dhe këta persona por më shumë edhe për t'u njohur. Duke qenë se ne jemi një këshill i ri, të njohim këto strukturat drejtuese duke qenë se ne zgjedhjet pritet të bëhen dhe mund të kemi edhe një strukturë drejtuese mbas zgjedhjeve është akoma një situatë zgjedhore. Këta persona që janë në drejtim të punëve propozoj që t'i kemi në mbledhjen e ardhshme dhe ne të përgatitemi më mirë për çështjet që kemi për diskutim. Ky është mendimi im në mënyrë që të mos zgjatemi sot sepse probleme ka shumë të mbartura, të vjetra edhe të reja kështu që mbledhjen e ardhshme t'i diskutojmë të gjithë problemet duke pasur prezentë dhe personat që mund t'i zgjidhin këto.

Mukades Gixhari . Faleminderit për mendimin. z. Enver.

Enver Memolla . Kryetare do i shtoj diçka tjetër kësaj që tha Shpati, jo të jenë vetëm në mbledhjen e ardhshme por të jenë në çdo mbledhje dhe pika të ndryshme të ketë vlerën e saj.

Silvana Aliu . Kisha diçka në lidhje me regjistrimin në klasat e para për dy shkollat, regjistrimi është lënë në mëshirë të fatit për një vendim të këshillit bashkiak të dikurshëm ose të vihet në funksion ose të ndryshojë vendimi. Ekziston vendimi, është marrë që njëra lagje të shkojë tek Qamil Gjuzi dhe njëra lagje të shkojë tek Shkolla tjetër.

Hekuran Xhani . Vendimi është i drejtë, kështu si thua ti apo është vendosur gabim një lagje të shkojë aty dhe tjetra atje, të kuptojmë thelbin e diskutimit?



Silvana Aliu . Është ndarë lagjja nr.1 , dhe lagjja nr.2, tani dy mësuese të njëjës shkollë mbledhin aq sa këtu fëmijët e tjerë ne mbesim kush të na vijë. Nuk është e drejtë kështu.

Enver Memolla . Sekretar mund të gjendet ky projektvendim që është marrë.

Ervis Shera . Është një vendim i hershëm nuk ekziston në arkivat e bashkisë tonë, duhet ta kërkojmë tek arkiva qendrore.

Silvana Aliu . Ne e kemi gjetur para dy vjetësh por nuk është vendosur tani ...

Ervis Shera . Ju keni marrë një formë vërtetimi nga nënkryetari atëherë që thonte ndarja është kjo lagjja 1 këtu dhe lagjja 2 këtu. Çështja është se atë vendim ju e kërkonte se është e drejtë ndarja apo... A duhet ta zbatojmë atë vendim?

Silvana Aliu . Duhet ta zbatojmë. Se sa të rrijmë dy mësues jo po çfarë të lejnë ato të gjithë mësuesit janë të barabartë .

Hekuran Xhani . Vendimi është i drejtë.

Enver Memolla . Sa klasa të para ka “Qamil Gjuzi” sa klasa të para ka “George Soros“ ?

Silvana Aliu . Tek “Qamil Gjuzi” po vjen në mbyllje ...

Enver Memolla . Sa klasa ka?

Silvana Aliu . Mezi po e hap një.

Enver Memolla . Sa kanë qenë aktualisht?

Silvana Aliu . Dy.

Enver Memolla . Po “George Soros” sa ka?

Silvana Aliu . Dy por ka një numër më të lartë marim 20.

Enver Memolla . Minimalja sa nxënës duhet të ketë klasa?



Silvana Aliu . Të paktën të ketë 18. Tani nuk është e drejtë që të penalizohen tani fëmijët do vijnë klasë të pestë.

Shpati Kolgega . Kështu ka qenë gjithmonë , ka qenë si shkollë e dorës së dytë , e kam fjalën e kanë trajtuar edhe nxënësit që ngelen... Tani duke qenë se janë dy shkolla një territor një ambient nuk e di pse i kemi akoma dy shkolla ajo është një shkollë qyteti të jetë njësoj për të gjithë. Nuk e di nga ana e drejtorisë arsimore se si funksionon kjo punë.

Sokol Gosa . Kjo është histori e gjatë aty duhet një drejtori, jo dy.

Shpati Kolgega . Dhe merr fund ky lloj diskriminimi se e dimë vetë jemi shkolluar aty. Çfarë ishin frëngjisht apo dorë e dytë shkonin këtej dhe çfarë ishin ...

Sokol Gosa . Rezi mund të më japësh përgjigje të shkurtër për ato që thashë.

Silvana Aliu . Nuk penalizohen vetëm mësuesit penalizohen edhe nxënësit edhe nxënësit aty shihen me një sy tjetër. Niveli është më i mirë se i shkollës matanë.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë drejtorin e financës.

Rezart Vogli . Për përgjigjet e kërkesave tuaja unë mund të jap një përgjigje jo ekzakte mbledhjen e ardhshme mund ta sjell më të shtjelluar që sa është fondi për stafin e bashkisë Rrogozhinë atë mund të them se them dot të saktë fare sot se nuk dua të them ndonjë shifër se jemi dhe online dhe nuk shkon. Kurse pikat tjera i kam mbajtur shënim edhe...

Sokol Gosa . O Rezi më fal po pak a shumë një numër mund të më japësh, 400, 500, 600?

Rezart Vogli . Nuk them dot numër se e ka zyra juridike dhe burimeve njerëzore ...

Sokol Gosa . Se informacion duhet të kesh ma merr mendja për numrin e punonjësve.

Rezart Vogli . Ka një numër punonjësish është miratuar në buxhet.

Sokol Gosa . Sa është?

Rezart Vogli . Nuk e kam unë të saktë nuk e ka financa numrin e saktë.

Sokol Gosa . Si se paska ti je shefi.



Rezart Vogli . Tek numri që është parashikuar në buxhetin e vitit 2023 janë parashikuar dhe punonjësit sezonalë...

Indrit Dedej . Ka një numër, ai punonjësi ku e merr rrogën? Këtë verë kemi 30 punëtorë plazhi. Nuk mund të thuash ti që nuk kam informacion sa punëtorë ka sa paguhen ose bëjmë një komision këtu dhe ...

Rezart Vogli . Përgjigjen e kësaj pyetje saktë fare e jep drejtoria juridike, sektori i burimeve njerëzore.

Shpati Kolgega . Mbledhjen e ardhshme do jenë të gjithë dhe drejtorat dhe përgjegjësit.

Sokol Gosa . Rezi duhet të jepet zgjidhje sidomos për këto emergjentet nuk pret koha.

Rezart Vogli . Pyetja e dytë a janë në Shqipëri, ku banojnë janë aktualisht këtu. I ka zyra juridike. A janë në përputhje me pozicionin e punës e ka zyra juridike dhe burimeve njerëzore. Pjesën e shërbim pastrimeve e ka zyra e Shërbimeve Olsi. Për plazhin flasim prap me drejtorinë juridike punonjësit sezonalë të plazhit. Arsimi është drejtori Fatmir Meçaj. Krahas meje edhe Visi sekretari mund t'i çojë një relacion një kërkesë për të gjithë stafin.

Sokol Gosa . Rezo në qoftë se është mundësia mund të ja transmetosh këto. Të paktën këto që mund të zgjidhen brenda 2-3 ditëve, kjo është sepse tjerat janë kërkojnë dhe kohën e vet.

Erind Tosku . Koli më fal, ti e di shumë mirë për çdo kërkesë që bën Këshilli Bashkiak për punonjësit për ndonjë pyetje apo problematika që lidhen me bashkinë Rrogozhinë kanë detyrim ligjor të vijnë këtu punonjësit e bashkisë. Kështu që nuk është në qoftë se ka dëshirë ja bëjmë kërkesën sot mbledhjen e ardhshme të gjithë punonjësit ...

Mitat Daja . Kjo duhet të jetë normë ato të jenë prezentë këtu duhet të jetë normë.

Sokol Gosa . Dakord faleminderit.

Rezart Vogli . Shumica e këtyre pyetjeve e kanë përgjigjen tek ai buxheti që është miratuar. Unë mund të vi e të them këtu sa fjalë të dua por ai buxheti i ka të miratuara nga këshilli bashkiak i ka të përcaktuara numrin e punonjësve, fondin i ka ai buxhet. E marim të vi këtu bashkë me buxhetin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Mukades Gixhari . Faleminderit. Ndonjë gjë tjetër? Duke ju falenderuar të gjithëve për prezencën mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 11 : 10^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 1orë ; 6 min ; 44 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 25 (njëzet e pesë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

**Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**